



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E POLICISË BASHKIAKE

Nr. 6990 prot.

Himarë, më 25.09 . 2026

NJOFTIM PËR LIRIMIN E HAPËSIRAVE PUBLIKE

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; ligjit nr. 89/2022, “Për Policinë Bashkiake”; VKM-së nr. 452, datë 26.07.2023, “Për miratimin e rregullores kuadër të Policisë Bashkiake”; ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; Vendimit të Këshillit Bashkiak Himarë nr. 4, datë 31.01.2020, “Për vendosjen e gjobave për shkeljet e kryera”, si dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe administrimin e mbetjeve, Drejtoria e Policisë Bashkiake njofton të gjitha subjektet tregtare dhe qytetarët që të lirojnë, brenda afatit të përcaktuar, hapësirat publike të zëna pa autorizim përpara bizneseve ose banesave të tyre. Nga trotualet, rrugët, sheshet dhe hapësirat e tjera publike duhet të hiqen tavolinat, karriget, vazot e luleve, strukturat rrethuese, tabelat, mallrat, materialet dhe çdo objekt tjetër i vendosur pa autorizim, i cili pengon lëvizjen e lirë të këmbësorëve, qarkullimin ose përdorimin e përbashkët të hapësirës publike.

Drejtoria e Policisë Bashkiake do të kryejë verifikime të vazhdueshme në terren. Subjektet tregtare dhe qytetarët duhet të lirojnë hapësirat publike të zëna pa autorizim brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të këtij njoftimi. Pas përfundimit të këtij afati, në rast të moslirimit vullnetar të hapësirave, do të merren masat administrative përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KRYETARI I BASHKISË

Vangjel Tavo

NË MUNGESË, ME URDHËR DHE ME DELEGIM

ZËVENDËSKRYETARI

Erifili Berberi

